

CAMBRIDGE SCHOOL

NJOHJA NGA UNIVERSITETET

- Shumë universitete në mbarë botën kërkojnë një kombinim të Cambridge International A Levels dhe Cambridge IGCSE, për të përmbushur kërkesat e tyre të pranimit. Megjithatë, disa kolegje në SHBA dhe Kanada do të pranojnë nxënës me pesë IGCSE të Kembrixhit. Shumë universitete në Mbretërinë e Bashkuar pranojnë kualifikimet e gjuhës angleze të Kembrixhit IGCSE, si dëshmi e kompetencës për studime universitare.

LËNDËT QË OFROJMË

- Matematika
- Fizika
- Kimia
- Biologjia
- TIK
- Anglisht

Provimi IGCSE i matematikës do të jepet në fund të klasës së 10-të, ndërsa lëndët e tjera do të jepen në fund të klasës së 11-të. Nxënësit që përfundojnë me sukses programin IGCSE, mund të përparojnë më vonë në programet AS Level ose A Level, në shkollën tonë.

4800

shkolla në 146
shtete ofrojnë
Cambridge
IGCSE



Programet Cambridge në “Turgut Ozal”



UNIVERSITY of CAMBRIDGE



CAMBRIDGE SCHOOL

1. Kurrikula ndërkombëtare

- Cambridge International është ofruesi kryesor i arsimit ndërkombëtar në botë. Programet e Kembrixhit shtrihen, sfidojnë dhe i frymëzojnë nxënësit e të gjitha niveleve e aftësive, pavarësisht nga konteksti i tyre kulturor.
- Si një shkollë e Kembrixhit dhe një shkollë shqiptare gjithashtu, kemi fleksibilitetin për të zhvilluar një kurrikul që i përshtatet nevojave të nxënësve tanë. Kështu, ne ofrojmë programin e Kembrixhit, krahas kurrikulës shqiptare. Nxënësit tanë përgatiten për provimet e Maturës Shtetërore, si edhe për provimet e Kembrixhit që ata zgjedhin.

2. Mësimdhënia dhe të nxënit

- Qasja e Kembrixhit ndaj mësimdhënies i ndihmon nxënësit që të bëhen të sigurt, të përgjegjshëm, reflektues, inovatorë dhe të angazhuar.

3. Vlerësimi


- Provimet e Kembrixhit zhvillohen në shkollën tonë, në muajt maj dhe qershor, me standardet e Kembrixhit. Këto provime më pas dërgohen në Angli për vlerësim. Kembrixhi i nxjerr rezultatet dhe i dërgon ato në shkollën tonë me certifikatat zyrtare të Kembrixhit. Provimet e Kembrixhit janë të drejta, të vlefshme dhe të besueshme.

4. Njohje ndërkombëtare

- Programet e Kembrixhit njihen dhe vlerësohen nga universitetet në mbarë botën, duke përfshirë vende, si: SHBA, MB, Australi, Kanada, Gjermani dhe më gjerë. Të gjitha universitetet në Mbretërinë e Bashkuar dhe mbi 800 universitete në SHBA pranojnë Cambridge International AS & A Levels.

5. Komuniteti global

- Komuniteti global i Kembrixhit përbëhet nga më shumë se 10 000 shkolla në mbi 160 vende.



CAMBRIDGE IGCSE

Cambridge IGCSE është kualifikimi ndërkombëtar më i njohur në botë për klasat e 10-ta dhe 11-ta. Ky program 2-vjeçar i ndihmon nxënësit që të zhvillojnë njohuri të thella dhe aftësi për të ardhmen. Nxënësit që regjistrohen për IGCSE në shkollën tonë, do të kalojnë një program të personalizuar për 2 vjet dhe do t'i nënshtrohen provimeve IGCSE të Kembrixhit, në fund të këtij programi.

Ofron programet e Cambridge në më shumë se **10000** shkolla në 160 shtete në mbarë botën

Cambridge punon me shkollat në mbarë botën për **160 vite**

PSE IGCSE?

- Është një nga kualifikimet më të njohura në mbarë botën.
- Nxiti të menduarit logjik e kritik të nxënësit dhe i ndihmon ata në zgjidhjen e problemeve dhe në zhvillimin e aftësive hulumtuese. Këto parime janë të dobishme dhe në harmoni të plotë me standardet globale të arsimit.
- Kurrikula e IGCSE ka lloje të ndryshme vlerësimesh për një lëndë të vetme, në mënyrë që të vlerësohen më mirë aftësitë dhe njohuritë e një nxënësi. Kjo i lejon ata që të eksplorojnë stilet dhe aftësitë e tyre unike të të mësuarit.
- Kurrikul e shkëlqyer për të përgatitur nxënësit për në universitete.
- Kurrikul që u ofron nxënësve një qasje praktike ndaj të mësuarit.